



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 “f” dhe “g” të Statutit të Komunës, Udhëzuesit të MASH-it për organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020/2021 në kushtet e pandemisë COVID-19, Kryetari i Komunës merr këtë:

### V E N D I M

#### PËR THEMELIMIN E TASK-FORËS NË KUSHTET E PANDEMISË COVID-19 NË KOMUNËN E VUSHTRRISË

1. Themelohet task-forca komunale për përcjellën e organizimit të mësimit në kushtet e pandemisë COVID-19 në arsimin fillor dhe të mesëm në Komunën e Vushtrrisë në këtë përbërje:
  - 1.1 **z. Xhafer Tahiri**, Kryetar i Komunës – kryesues,
  - 1.2 **z. Afrim Namani**, Drejtor i DKA, - zëv.kryesues
  - 1.3 **z. Lutfi Gërguri**, Drejtor BF, - anëtar
  - 1.4 **z. Sylejman Mehulli**, Drejtor i SHPS, - anëtar
  - 1.5 **znj. Violeta Pllana**, Përgjegjëse e shërbimit social në QPS, - anëtare
  - 1.6 **z. Bujar Pllana**, Inspektor Sanitar,
2. Mbledhjet e Task-forcës i udhëheqë Kryetari i Komunës në cilësi të kryesuesit të mbledhjes.
3. Vendimet që merren në mbledhjet e task-forcës i nënshkruan kryesuesi i asaj mbledhje.
4. Task-forca do të bëjë verifikimin e skenarëve me nivelin e rrezikshmërisë në Komunë dhe kushtet e shkollës.
5. Do të bëjë monitorimin e zbatimit të skenarëve në vitin e ri shkollor si dhe bëjë përcaktimin e masave përkrahëse për shkollat në territorin e Komunës.

6. Task-forca do të përpiloj një plan ë punës në të cilin do të përfshihen mbledhjet e rregullta dhe mbledhjet që do të mund të mbahen varësisht prej nevojës, formati i atyre mbledhjeve (sipas nevojës mund të ftohen edhe pjesëmarrës tjerë), mënyra e vendimmarrjes.
7. Task-forca, për punën dhe vendimet që do të i merr i raporton organeve përgjegjëse sipas ligjit.
8. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Xhafer Tahiri



Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të task-forcës
- Arkivit të Sekretarisë